**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA KAMËZ**

# NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

## DREJTUAR BANORËVE TË BASHKISË KAMËZ DHE TË GJITHË PALËVE TË INTERESUARA.

Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 139/2025 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, të ligjit Nr. 146/2014 " Për njoftimin dhe konsultimin publik", ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", rregullores së Këshillit Bashkiak "Për Konsultimin Publik.

Ju njoftojmë se do të zhvillohet konsultim publik mbi temën:

- **PLANI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2025-2028**

Ditën e mërkurë, datë 16.07.2025, në orën 09:00 në shkollën Ahmet Zogu, lagjia 5 Bathore, dhe në orën 09:30 në kopshtin Borëbardha, Paskuqan.

Ky konsultim do të organizohet me përfaqësues të: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Kamëz; banorëve të njësisë Administrative Paskuqan dhe lagjeve administrative nr. 1, 2 dhe Bathore; shoqërisë civile; përfaqësues të Bashkisë Kamëz; institucione publike dhe jopublike; organizata jofitimprurëse dhe grupe interesi.

Konsultimi publik synon të njohë grupet e interesit me analizën e situatës, fushat e ndërhyrjes, qëllimin, objektivat dhe planin e e veprimit.

Mirëpresim rekomandime, propozime dhe sugjerime konkrete mbi Planin e Arsimit Parauniversitar 2025-2028 për të përmirsuar përmbajtjen e dokumentit drejt një plani më efektiv dhe të zbatueshëm, të

cilat mund të dërgohen në adresën e mëposhtme të e-mailit:

-konsultim.publik@kamza.gov.al Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

Jeni të lutur të merrni pjesë, pasi pjesëmarrja juaj në këtë dëgjesë është shumë e rëndësishme për garantimin e një procesi sa më transaparent dhe gjithëpërfshirës.